

VENDIM I

Nr. 311, datë 5.5.2010¹

PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT, TË PËRMBAJTJES DHE TË MËNYRËS SË NJOFTIMIT PUBLIK PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHETËTOR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN

I përditësuar

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njoftimi për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, në zonat me përparësi turizmin, publikohet:

a) në faqen zyrtare të ALUIZNI-t dhe të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

b) në dy gazeta kombëtare, për 5 ditë të njëpasnjëshme kalendarike;

c) pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Njoftimi publik përmban:

a) afatin brenda të cilit subjekti i interesuar dhe personi i stimuluar duhet të paraqesin dokumentet pranë ALUIZNI-t, sipas ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”;

b) llojin e dokumenteve që duhet të paraqesë subjekti i interesuar/personi i stimuluar;

c) masën e tarifës që duhet paguar.

3. Efektet financiare të njoftimit publik përballohen nga buxheti i ALUIZNI-t.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

¹ VKM nr. 311, datë 5.5.2010 është botuar në Fletore Zyrtare nr.63/2010.
VKM nr. 45, date 21.01.2015 është botuar në Fletore Zyrtare nr.7/2015.